ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komuna Gjilan**

Për aktivitetin e Prokurimit: **GI 651-16-052-211**

Sa i përket tenderit për ***"Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike"***

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 94/17
Datë/Datum. 03.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"EL-BAU" Sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Nato 99 (Rr. Tranzit drejtimi i magjistrales Gjilan – Ferziaj)
(Adresa)

Gjilan — *(Vendi)*

60 000 — *(Kodi postar)*

044 244-330 — *(Numri Telefonit)*

(Numri i Faks-it)

Suad Pireva
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
elbau_gjilan@hotmail.com
(Adresa elektronike)

Brenda afatit ligjor 03.04.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "EL-BAU" LIMITED LIABILITY COMPANY
(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës e parashtron ankesën vet përmes përfaqësuesit të kompanisë "El-Bau"Sh.p.k.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- *Data e publikimit te njoftimit për Kontratës 03.08.2016, publikuar ne ueb faqen e KRPP-së*
- *Afati i fundit per dorezimin e ofertave ka qene 23/08/2016, Komuna e Gjilanit*
- *Hapja e ofertave nga perberja e komisionit te AK-se ne prezencen e ofertusve eshte bere me date 23/08/2016 ora 14:30, Zyra e Prokurimit Komuna e Gjilanit*
- *Kriteret per dhenien e Kontrates:* ***Çmimi me i Ulet***
- *Njoftimi për Dhënie të Kontratës OE "ECO HIGJIENA" SHPK - Gjilan është përgaditur me dt. 08.11.2016;*

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve bazuar në nenin 108/A i LPP-së

- *Kërkesa për Rishqyrtim e dt. 21.03.2017 parashtruar nga OE "EL-BAU"* për AK-Komunës Gjilan *kundër vendimimeve të AK-së si në vijim: Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar "El-Bau", e dt. 20.03.2017 dhe Njoftimit për Dhënie të Kontratës për OE "Eco-Higjiena" e dt. 17.03.2017*
- *Përgjigjja nr.16-27774/2 dt.protokoli 22.03.2017 (e jo vendim që ka pasur për obligim ligjor të nxjerrë AK) për Refuzimin si të pabazuar të ankesës së OE "El-Bau" dt.21.03.2017, e nxjerrë nga Drejtori i Zyrës së Prokurimit Salih Kqiku,* ***e pranuar me dt. 03.04.2017***

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Procesi i hapjes se ofertave ne kete aktivitet prokurimi është bërë nga komisioni i hapjes së tenderëve në prezencën e përfaqësuesve të OE pjesëmarrës të cilët kanë dorëzuar ofertat e tyre (shih procesverbalin e hapjes).

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

Me datë 20.03.2017 përmes komunikimit elektronik (shih email-in) nga Departamenti i Prokurimit, Komuna e Gjilanit na është dërguar Letra standandarde për tenderuesin e eliminuar "El-bau" Sh.p.k., në të cilën është shënuar se jemi eliminuar/diskualifikuar dhe tenderi jonë është refuzuar për arsye: ***Sepse Dokumeneve të Dosjes së Tenderit nuk ia keni***

bashkangjitur fotot për pajisjet përcjellëse të makinave përkatëse ashtu siç është kërkuar, njëherit nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme se posedoni referenca për mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike - gjelbruese

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Bazuar në nenin 108A të LPA-së, nenit 4 dhe 5 të Rregullave për parashtrim të ankesave – FO3, në cilësi të "palës së interesuar" siç parashikohet me këtë ligj brenda afatit ligjor me datën 21.03.2017 kundër vendimit – Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar "El-Bau" të dt. 20.03.2017 dhe Njoftimit për Dhënie të Kontratës OE "Eco-Higjiena" të dt. 17.03.2017 kemi parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit e cila udhëheq këtë aktivitet te prokurimit.

Provë: Shih Kërkesën për Rishqyrtim dt. 21.03.2017

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

OE "EL-BAU" Sh.p.k. në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik-material lidhur me me gjasa potenciale për fitimin e kontratës në këtë lëndë nëse AK gjatë rivleresimit do të zbatonte drejt dhe ligjshëm vlerësimin dhe shqyrtimin e prokurimit, bazuar në nenin 109 lidhur me nenin 111 të LPP-së, nenit 9 dhe 10 të Rregullave për parashtrim të ankesave – FO3, konsideron se komisioni vlerësues dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit i AK-së Komunës së Gjilanit gjatë fazës së Rivlerësimit që ka rezultuar me nxjerrjen e vendimit Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar te dt. 20.03.2017 dhe vendimit përfundimtar - Njoftimit për Dhënien e Kontratës të dt. 17.03.2017 OE "Eco Higjiena" dhe me rastin e nxjerrjes së Përgjigjës nr.16-27774/2 dt.protokoli 22.03.2017 (nuk është nxjerrë vendim siç e përcakton neni 108/A par.10 të LPP-së dhe neni 8 i Rregullave për Parashtrim të Ankesave - FO3) për Refuzimin si të pabazuar të ankesës së OE "El-Bau" dt.21.03.2017, e nxjerrë nga Drejtori i Zyrës së Prokurimit Salih Kqiku, **<u>të cilën e kemi pranuar me dt. 03.04.2017</u>**, me qëllim ka ripërsëritur shkeljet e dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit sekondar të prokurimit (pretendimeve ankimore) të ngritura në Kërkesën për Rishqyrtim të dt.09.11.2016 dhe Ankesën e dt. 02.12.2016 dhe atë shkeljet e listuara si në vijim:

1. Neni 1 par.1,2.3 te Ligjit Nr.04/L-042, Qëllimi;
2. Neni 6 par.1 i Ligjit Nr.04/L-042, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
3. Neni 7 par.1,2,4 te Ligjit Nr.04/L-042, Barazia në Trajtim / Jo Diskriminim;
4. Neni 52 par.3 i LPP-së nr.04/L-042, Njoftimi i kritereve për dhënien e kontrates;

5. Neni 56 të LPP-së nr.04/L-042,Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;
6. Neni 59 par.4 i LPP-së nr.04/L-042, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
7. Neni 60 par. 1, nënpar 1.1 i LPP-së nr.04/L-042, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
8. Neni 72 i LPP-së nr.04/L-042, Dokumentacioni dhe informacioni shtese;
9. Neni 108/A par 6 lidhur me par 12 dhe par.10, i LPP-së nr.04/L-042, Zgjidhja preliminare e marrveshjeve - nenin 6.3 lidhur me nenin 7.2 dhe nenin 8 i Rregullave për Parashtrim të Ankesave (FO3);

10. Neni 18.5 i Rregullave për Udhëzuesin Operativ për prokurim publik;
11. Neni 26.1, 26.2 i Rregullave për Udhëzuesin Operativ për prokurim publik;
12. Neni 26.6, pika 1.3, 1.4 i Rregullave për Udhëzuesin Operativ për prokurim publik;
13. Neni 26.8 i Rregullave për Udhëzuesin Operativ për prokurim publik;
14. Neni 4.4 (Parimet bazike të prokurimit publik) i RrUOPP;

1) **Shkelje të Vendimit PSH.nr. 446/16** të dt.25.01.2017
Përveq shkeljeve të dispozitave të lartshënura me rastin e procedurës së Ri-Vlerësimit janë kryer shkelje të dyfishta ngase AK nuk iu është përmbajtur Vendimit PSH.Nr.446/16 të OSHP-së që ka pasur detyrim ligjor ngase me anë të këtij vendimi është vërtetuar se të gjitha pretendimet ankimore të OE "El-Bau" siç u cekën më lartë janë të bazuara dhe se i njejti është i përgjegjshëm ndërsa për OE "Eco Higjiena" të cilën AK e kishte zgjedhur për dhënie të kontratës është vërtetuar se nuk është i përgjegjshëm pasi që nuk ka plotësuar kriterin e specifikuar te kërkesat e mundësive teknike dhe profesionale siç janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Bazuar në gjendjen faktike e cila është vërtetuar edhe juridikisht përmes Vendimit PSH.nr.446/16 të dt.25.01.2017, AK gjatë Ri-Vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit me rastin e marrjës së vendimit për eliminim të ofertës së OE "El-Bau" me arsyet e cekura në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar te dt. 20.03.2017 dhe vendimit përfundimtar për dhënie të kontratës OE "Eco-Higjiena" përmes Njoftimit për Dhënien e Kontratës të dt. 17.03.2017, me qëllim ka bërë shkelje të dyfishta ligjore ngase ka ripërsëritur shkeljet e dispozitave të lartshënuara të cilat ishin pretendime ankimore në Kërkesën për Rishqyrtim të dt. 09.11.2016 dhe Ankesën e dt. 02.12.2016. Paneli Shqyrtues i OSHP-së i caktuar për shqyrtim të Ankesës Nr.446/16 pas shqyrtimit kryesor me dt. 25.01.2016 kishte nxjerrë Vendimin PSH.nr.2016 me anë të cilit kishte vendosur:

- **Të APROVOJË si të bazuar Ankesën e OE "El-Bau" Sh.p.k**. ngase kishte vërtetuar se qëndrojnë pretendimet ankimore të OE ankues për shkelje të nenit 7 dhe 56 të LPP-së për faktin se arsyet e dhëna nga AK për eliminimin e të njejtit referuar Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të dt.04.11.2016 nuk qëndrojnë për arsyet se OE ankues lidhur me kërkesën e specifikuar në pikën 9.2 ka ofruar dëshmi siç janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë;

- **Se OE "Eco-Higjiena" i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka plotësuar kriterin e specifikuar te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale në pikën 9.2.2 ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe se oferta e të njejtit nuk është e përgjegjshme**, ndërsa është vërtetuar se AK ka bërë shkelje të nenit 59.4 të LPP-së në lidhje me rastin konkret – vlerësimin si të përgjegjshme të ofertës së OE "Eco-Higjiena" dhe njëkohësisht dhënien e kontratës, dhe

- Për shkak të shkeljeve dhe mosrespetimit të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë procesit të vlerësimit të ofertave lidhur me këtë aktivitet kishte urdhëruar AK-në që të Anulojë vendimin për dhënie të kontratës OE "Eco-Higjiena" dhe lëndën ta kthej në Ri-vlerësim dhe brenda 10 ditësh ta informoj Panelin Shqyrtues me të gjitha veprimet e ndërmarrura lidhur me këtë prokurim **gjë e cila nuk ka ndodhur për faktin se Rivlerësimi qëllimshëm është stërzgjatur për afro dy muaj.**

Bazuar në vendimet e nxjerra, Njoftimit për dhënie të kontratës OE "Eco-Higjiena" të dt.17.03.2017 dhe Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar OE "El-Bau" të dt.20.03.2017 të cilat paraqesin rezultatet e njejta si në vendimet paraprake të ankimuara rezulton se komisioni vlerësues dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit i AK-së gjatë rivlerësimit nuk ka respektuar dhe ju përmbajtur vendimit PSH.nr.446/16 për të ndërmarrë veprime korrigjuese për të rregulluar aktivitetin e prokurimit në pajtueshmëri me këtë ligj ngase për faktin se ndaj të njejtit vendim AK nuk kishte ushtruar ankesë në gjykatë, ajo kishte obligim detyrues për zbatimin në plotni të vendimit në fjalë

I. Përshkrimi i rrethanave faktike dhe ligjore që argumentojnë shkeljet nga AK lidhur me Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar OE "El- Bau" të dt.20.03.2017

Aryetimi i dhënë (përsëritur nga arsyetimi paraprak për eliminim) në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të dt. 20.03.2017 në të cilin është konstatuar se jemi diskualifikuar për këtëo arsye: citoj " *Sepse Dokumeneve të Dosjes së Tenderit nuk ia keni bashkangjitur fotot për pajisjet përcjellëse të makinave përkatëse ashtu siç është kërkuar,njëherit nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme se posedoni referenca për mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike – gjelbruese"*, në kontekst të gjendjes faktike dhe ligjore paraqet vërtetim të gabueshëm të gjendjes faktike dhe është plotësisht vendim i padrejtë dhe i shoqëruar me shkelje të rënda të ligjit me qëllim të krijimit të rrethanave serioze për të penguar të drejtën për ta fituar kontratën edhe pse OSHP përmes Vendimit PSH.nr.446/16 ka vërtetuar se nuk qëndrojnë aryetimet e AK-së per eliminim që nënkupton se oferta jonë ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike te specifikuara në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë dhe se qëllimi i AK-së është favorizimi dhe drejtimi i dhënies së kontratës OE "Eko – Higjiena" për të cilën i njejti vendim vërteton se nuk është i përgjegjshëm.

Përtej kësaj ju si AK jeni plotësisht në njohuri se OE "El-Bau" për të plotësuar kërkesën nga neni 9.1 pika 2 e FTD-së së dosjes së tenderit lidhur me nenin 9.2 pika 2, lidhur me pjesët tjera

të makinerisë (makina për krasitje, kositje,ujitje, formësim dhe dekorim) ka ofruar dëshmi DUD-at[1] me nr: IE 0214533D; IE 0187157V; IE 0106834V; R 10786, gjithsej nëntë (9) pajisje të cilat janë evidentuar me llojin e pajisjes, sasinë e pajisjes dhe të dhënat tjera në listën për pajisjet dhe mekanizmin e obligueshëm për projektin GI-651-16-052-221 sipas nr rendor 2,3,4, 7 dhe 12 të kësaj liste përmes të cilëve faktikisht dhe ligjërisht vërtetohet se pajisjet e lartshënuara janë në posedim të OE "El-Bau". Ndërsa fotografija në të cilin thirrreni ju nuk paraqet një akt juridik dhe një dokument i cili ka peshë faktike dhe saktësie më shumë se një akt juridik (DUD, faturë, kontratë etj) dhe në rast se jus i AK keni vënë në pikpyetje apo dyshuar se ne nuk i kemi në posedim pajisjet përcjellëse të makinave përkatese keni çenë të obliguar ligjërisht që të vini në vendpunishtën e biznesit për ta vërtetuar një gjë të tillë e cila ndodhet jo më larg se 2-3 Km nga zyra e juaj.

Për më tepër në aspektin ligjor arsyetimi i mbështetur në foto (*se nuk kemi bashkangjitur fotot për pajisjet përcjellëse të makinave përkatëse*) është shkelje absolute (fotografia nuk vërteton autenticitetin) dhe në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.
Sipas nenin 26.8 të Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (më tej RrUopp), nenit 69.4 të LPP-së Nr.04/L-042, qartësisht ligjvënsi me shprehje të qarta nuk shënon fjala foto. Rrjedhimisht dosja e tenderit është akt më i ulët juridik dhe nuk mund të jetë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, RrUopp, respekitivisht nenin 69.4 të LPP, nenin 18.15 të RrUopp dhe nenin 26.8 të RrUopp të cilat kanë epërsi në krahasim me dosjen e tenderit. Çdo veprim në kundërshtim me ligjin - LPP, RrUopp, paraqet shkelje absolute, dhe ndonjë vendim të mundshëm në kundërshtim me ligjin, rregullin e bënë NUL.

Po ashtu zyrtari përgjegjës i prokurimit i AK- Komunës së Gjilanit e ka ditur apo ka pasur obligim ta dijë sipas detyrës zyrtare dhe funksionit që ushtron ***se kjo çështje është vërtetuar dhe vendosur me Vendimin PSH.nr.446/16 dhe se vendimi i panelit shqyrtues të OSHP-së si shkallë e dytë posa ta merr formën e prerë është akt juridik i detyrueshëm për AK-në, andaj ligjërisht kjo është qështje është e shqyrtuar "RES JUDIKATA" dhe përsëritja e arsyetimit të njejtë për lëndën e njejtë i cili është shqyrtuar më parë është shkelje e rëndë e parimeve bazike dhe normave ligjore të LPP-së.***

Tutje pjesa e arsyetimit tjetër i AK-së për eliminimin e OE "El- Bau" se: citoj ...,*njëherit nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme se posedoni* ***referenca për mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike – gjelbruese***", fillimisht ka të bëjë me shkelje të nenit 52.3 të LPP-së në të cilën shprehimisht është shënuar se: citoj: "*Vetëm kriteret e matshme* ***dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim.***".
Në pikën 9.1.1 të FTD-së së dosjes së tenderit është paraqitur kërkesa në të cilën thuhet: "*kontrata të natyrës së ngjajshme të realizuara në tri vitet e fundit minimum dy kontrata.* Në pikën 9.2.1 ku kërkohen dëshmitë dokumentare lidhur me kërkesën nga neni 9.1.1 të FTD se dosjes së tenderit thuhet: "***Lista e kontratave të ngjajshme*** *të realizuara në tri vitet e fundit minimum dy kontrata* ***ku duhet të dëshmohet me raporte mbi pranimin e shërbimeve ose referenca*** *ku qart duhet të ceket emri i projektit koha e realizimit të shërbimit vendi dhe vlera e projektit*".
Duke ju referuar kërkesës nga pika 9.1.1 dhe pikës 9.2.1 të FTD së dosjes së tenderit rezulton se referencat e kërkuara duhet të jenë lidhur me ***kontratat për punë të ngjajshme*** dhe se nuk qëndron dhe nuk është përcaktuar në dosje të tenderit pretendimi i AK-së siç e ka përdorur si arsye për eliminimin e OE "El-Bau "***referenca për mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike – gjelbruese***".

Përtej kësaj ky arsyetim paraqet vlerësim të rrejshëm/mashtrues që rezulton me vërtetim të gabueshëm të gjendjes faktike ngase siç mund të vërtetohet nga dokumentet që përbëjnë përmbajtjen e dosjes së tenderit të OE "El-Bau" **ekzistojnë dëshmitë dokumentare për 4 kontrata të shoqëruara referenca** (ku saktë ceket emri i projektit, koha e realizimit,vendi dhe

[1] Dokument Unik Doganor

vlera e projektit) për kontrata të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit siç kërkohet te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale në pikën 9.1.1 dhe 9.2.1 të FTD së dosjes së tenderit

SI KA MUNDËSI për AK-në që herën e parë gjatë administrimit të procesurës së vlerësimit ka vlerësuar se i kemi referencat të cilat lidhen me plotësimin e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nga pika 9.2-1) lidhur me pikën 9.1-1) e ndërsa herën e dytë gjatë rivlerësimit nuk janë. Përveq argumeneteve faktike të mbështetura edhe në ligj këtu ashiqare kemi të bëjmë me tentativë për vlerësim të rrejshëm/mashtrues që ka si qëllim arritjen e rezultatit për eliminimin/diskriminimin e OE "El- Bau" dhe drejtimin e dhënies së kontratës OE "Eco –Higjiena".

Në përfundim duke pasur parasysh gjitha të cekurat si më lartë të cilat janë argumentuar me fakte dhe janë të mbështetura në baza ligjore konsiderojmë se AK gjatë udhëheqjes së procedurës së Rivlerësimit me dashje ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike me anë të paraqitjes së fakteve të rreme dhe ka fshehur faktet vendimtare duke mos i vlerësuar fare për qëllimet e sipërtheksuara, dhe si pasojë e përsëritjeve të dyfishtë të shkeljeve paraprake Ri-vlerësimin e ka bërë duke shkelur nenin 51.3, nenin 56, nenin 59.4, neni 60 paragrafi 1.1, neni 72 lidhur me nenin 1, nenin 6 dhe nenin 7 të LPP-së, ngase po të trajtohej oferta jonë në mënyrë të barabartë dhe në bazë të kritereve të kërkuara ligjore potencialisht gjasat ishin për ta fituar kontratën.

II. Përshkrimi i rrethanave faktike dhe ligjore që argumentojnë shkeljet nga AK lidhur me dhënien e kontratës OE "Eco Higjiena" të dt. 17.03.2017

Komisioni i vlerësimit i caktuar për të bërë Ri-vlerësimin e këtij aktiviteti prokurimi si dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit i AK-së z. Sali Kqiku me rastin e marrjes së vendimit përfundimtar për dhënien e kontratës OE "Eco-Higjiena" të dt. 17.03.2017, në bazë të funksionit që e ushtron e ka ditur apo do të duhej ta dijë se ligjërisht në bazë të normave ligjore të LPP-së dhe rregullave të prokurimit OE "Eco-Higjiena" në asnjë rrethanë nuk ka as më të voglëm mundësi që të shpallet fitues dhe të jetë nënshkrues i kësaj kontratë ngase në lidhje me këtë aktivitet OSHP përmes Vendimit PSH.nr.446/16 të dt. 25.01.2017 ka vërtetuar se **OE "Eco-Higjiena" i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka plotësuar kriterin e specifikuar te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale në pikën 9.2.2 ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe se oferta e të njejtit nuk është e përgjegjshme**.

Për faktin se zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe as ndonjë përfaqësues ligjor i AK-Komunës së Gjilanit nuk ka ushtruar Kërkesë–Padi në gjykatë dhe nuk ka ndonjë vendim për masë të sigurisë, zyrtari përgjegjës i prokurimit është dashur që ta dijë se vendimi në fjalë është i ekzekutueshëm/përmbarimor brenda afatit të përcaktuar 10 ditësh gjë që nuk e ka bërë pasi Ri-vlerësimi ka filluar pas dy muajsh, ai ka pasur detyrim ligjor si të vetmen mundësi gjatë rivlerësimit të zbatoj në plotni vlerësimet që janë vërtetuar me këtë vendim duke ndërmarrë veprime korrigjuese për të përmirësuar shkeljet ligjore të cilat janë vërtetuar nga OSHP se i keni bërë gjatë vlerësimit paraprak. Dhe në vend se ta zbatojë plotësisht vendimin PSH.nr.466/16 siç ka pasur detyrim ligjor AK gjatë Rivlerësimit ka bërë shkelje të dyfishta duke nxjerrur rezultate identike si në vendimet paraprake me çka nënkupton se me dashje dhe me qëllim të caktuar për të drejtuar dhënien e kontratës në drejtim të OE "Eco-Higjiena" keni ripërsëritur dhe dyfishuar shkeljet e njejta ligjore.

Më tej OE "El-Bau" përmes Kërkesës për Rishqyrtim të dt.09.11.2016 dorëzuar pranë AK-së dhe në Ankesën e deponuar në OSHP të dt.02.12.2016 të cilën AK si palë e ka pasur në posedim kopjen e ankesës ka qenë plotësisht në njohuri me pretendimet,informatat dhe dëshmitë e ofruara nga ana jonë se OE "Eco-Higjiena" ka probleme të mëdha financiare duke filluar nga

detyrimet tatimore ndaj ATK përfshirë vënien e bllokimit të llogarive bankare, detyrime tjera ndaj furnitorëve dhe operatorëve tjerë, procedura gjyqësore lidhur me kontestet administrative, civile, procedura të arbitrazhit, procedura të vënies së pengut mbi pajisjet dhe mekanizmin e kompanisë. **Dhe në kuptim të nenit 65 par.4.5 dhe 4.8 të LPP-së OE në fjalë nuk plotëson kërkesën nga pika 6.4-3) e FTD-së së dosjes së tenderit dhe si rezultat i kësaj gjendje faktike OE në fjalë nuk mund të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të ekzekutimit e ndonjë kontrate pasi që iu nënshtrohet vendimeve administrative i cili i suspendon pagesat (bllokim të llogarive bankare) në kuptim të paragrafit 4.5 të këtij neni, për vonesë të detyrimeve të mëdha në pagimin e tatimeve në kuptim të paragrafit 4.8 të këtij neni,andaj edhe tenderi i tij ishte dashur që të refuzohej si tender i papërgjegjshëm.**

Në lidhje vërtetimin e gjendjes së plotë faktike AK ka pasur obligim ligjor për tu përkujdesur sipas detyrës zyrtare që të verifikoj, vërtetoj informatat që ishin pretendime ankimore në kërkesën për rishqyrtim duke ju drejtuar organeve kompetente (ATK, gjykata, ARBK-Sektori i Pengut, përmbarues privat) t'i verifikoj të gjitha këto informata mirëpo konsiderojmë me dashje dhe qëllim që të drejtoj dhënien e kontratës te OE "Eco-Higjiena" nuk ka shprehur interesim për të ndërmarrë veprimet konkrete

Lidhur me këto pretendime të përshkruara në Kërkesën për Rishqyrtim të dt. 09.11.2016 dhe në Ankesën Nr.446/16 eksperti shqyrtues i prokurimit Shefqet Emërllahu i caktuar për shqyrtimin e pretendimeve ankimore në Ankesën Nr.446/16 në Sqarimin nr. 4 të Raportit mbi Ekspertizën e Ekspertit Shqyrtues Nr.466/16 të dt. 10.01.2017 pjesërisht për njërën ndër pjesët e pretendimit ankimor ka siguruar informata zyrtare ***nga të cilat vërtetohet se pajisjet e ofruara nga OE "Eco Higjiena" për të plotësuar kërkesën në pikën 9.1-2), cisterna të ujit me kapacitet 6000 litra me targa 06-949-AH dhe targa 06-241-AU janë vënë në procedurë të Pengut nga Administrata Tatimore e Kosovës.***

Gjithashtu eskperti shqyrtues gjatë shqyrtimit fillestar të kësaj lënde bazuar në shqyrtimin dhe verifikimin e dosjes së OE "Eco-Higjiena" ***ka vërtetuar se kjo kompani lidhur me pajisjet tjera (makina për krasitje,kositje,ujitje,formësim dhe dekodim) nuk ka ofruar asnjë dëshmi materiale që i posedon këto pajisje në pronësi dhe se fotot e prezentuara me asnjë shenjë identifikuese (mbishkrim) nuk dëshmojnë se kompania në fjalë i ka në pronësi dpo posedim këto pajisje, andaj edhe ka vlerësuar se nuk është plotësuar kjo kërkesë nga ana e OE "Eco-Higjiena" i rekomanduar për kontratë.***

SI KA MUNDËSI për AK-në të ri-vlerësohet për të dytën herë si i përgjegjshëmn i njejti OE (ECO-HIGJIENA) kur ka ditur se i njejti sipas Raportit të Ekspertit Shqyrtues dhe Vendimit PSH.nr.446/16 është vërtetuar dhe vendosur se OE "Eco-Higjiena" i rekomanduar për dhënie të kontratës siç vërehet nga pjesa e shkëputur e vendimit si në vijim:

> Pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoritetit kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues vlerëson se qëndron, për arsye se në bazë të nenit 59 paragrafi 4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, ndërsa në rastin konkret operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka plotësuar kriterin e specifikuar te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ne pikën 9.2 pika 2, ashtu siç janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Këtu ashiqare kemi të bëjmë me tentativë për vlerësim të rrejshëm/mashtrues që ka si qëllim arritjen e rezultatit për eliminimin/diskriminimin e OE "El- Bau" dhe drejtimin e dhënies së kontratës OE "Eco –Higjiena".

Duke pasur parasysh gjitha të cekurat si më lartë të cilat janë argumentuar me fakte dhe janë të mbështetura në baza ligjore konsiderojmë se AK gjatë Rivlerësimit me dashje ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike me anë të paraqitjes së fakteve të rreme dhe ka fshehur faktet vendimtare duke mos i vlerësuar fare për qëllimet e sipërtheksuara, dhe si pasojë e përsëritjeve të dyfishtë të shkeljeve paraprake Ri-vlerësimin e ka bërë duke shkelur nenin nenin 56, nenin 59.4, neni 60 paragrafi 1.1, neni 72 lidhur me nenin 1, nenin 6 dhe nenin 7 të LPP-së.

III. Përshkrimi i arsyeve ligjore dhe faktike që tregojnë shkeljet ligjore të LPP-së lidhur me Përgjigjës nr.16-27774/2 dt.protokoli 22.03.2017

Fillimisht ky akt nuk është nxjerrur në pajtim me bazën ligjore siç përcaktohet te neni 108/A par.10 të LPP-së dhe neni 8 i Rregullave për Parashtrim të Ankesave - FO3. Në përmbajtjen e arsyetimit nuk është paraqitur asnjë konstatim faktik në konteks të gjendjes faktike dhe pretendimeve ankimore mirëpo janë ripërsëritur shkeljet e njejta duke përshkruar arsyetimet paraprake nga Përgjigja Nr.16-115636 të dt.22.11.2016 si dhe duke shtuar një fjali të ngjashme si në letrën standarde për eliminimin e OE "El-Bau" se kinse nuk posedojmë referenca për mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike –gjelbëruese edhe pse një kërkesë e tillë nuk është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë sipas pikës 9.1.1 dhe 9.2.1 të FTD-së ku shprehimisht është kërkuar: **"kontrata për punë të ngjashme"** dhe faktin se OE "El-Bau" për ta plotësuar këtë kërkesë ka ofruar <u>dëshmitë dokumentare për 4 kontrata të shoqëruara referenca</u> (ku saktë ceket emri i projektit, koha e realizimit,vendi dhe vlera e projektit) për kontrata të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit siç kërkohet te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale në pikën 9.1.1 dhe 9.2.1 të FTD së dosjes së tenderit.

Shkelje tjetër e cila konsiderohet si shkelje e rëndë duke shkelur njërin ndër parimet kryesore të prokurimit TRANSPARENCËS ngase PërgjigjenNr.prot të nxjerrur sipas vulës së protokollit 016/27774/2 me dt. 22.03.2017 nuk n aka komunikuar fare siç obligohet me nenin 108/A par. 12 të LPP-së dhe nenin 7.2 i Rregullave për Parashtrim të Ankesave (FO3), ngase të njejtin e kemi pranuar sot me dt. 03.04.2017 nga zyra e protokollit të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të AK-së vetëm pasi kemi shkuar në zyrën e prokuyrimit për tu interesuar dhe aty na është thënë se është marrë vendimi dhe është dërguar në zyrën e protokollit të Drejtorisë së Administratës së përgjithshme të AK-së

Andaj duke pasur parasysh kontekstin e gjendjes faktike dhe ligjore bazuar në faktet e paraqitura si më lartë të cilat janë të argumentuara me fakte të bazuara me saktësi faktike dhe ligjore duke përfshi edhe vendimin e formës së prerë/ekzekutues, Vendimi PSH.nr.446/16, AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave të lartshënuara të LPP-së dhe akteve nënligjore dhe ka bërë vërtetimin e gabueshëm të gjendjes faktike duke mos vlerësuar faktet vendimtare që si pasojë nga shkeljet e pretenduara ka rezultuar me dëmtimin e konzorciumit OE "El-Bau&Vemor" dhe tani pritet të realizohet rezultati i dëshiruar dhënia e kontratës OE "Eco-Higjiena", kërkojmë nga OSHP – Paneli Shqyrtues në OSHP pas shqyrtimit e marrjes në konsideratë duke ju dhënë peshë të gjitha fakteve të paraqitura në ankesë, dhe të merr këtë:

VENDIM

- **MIRATOHET** si e bazuar ankesa e OE "EL-BAU" me seli në Gjilan;
- **ANULOHET** Njoftimi -Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar OE "El-Bau" e dt. 21.03.2017, Anulohet Njoftimi për dhënie të kontratës i dates 17.03.2017, Anulohet *Përgjigjja nr.* 016/27774/2 me dt. 22.03.2017 *për refuzimin si të pabazuar të ankesës së OE "El-Bau" dt.20.03.2017 e nxjerrë nga Drejtori i Zyrës së Prokurimit pranë AK-së,*
- VËRTETOHET si çështje e shqyrtuar dhe gjykuar "RES JURIDIKATA" në bazë të Vendimit

PSH.nr.446/16 ngase nga AK janë përsëritur arsyetimet e njëjta për lëndën e njejtë të cilat janë gjykuar me anë të këtij vendimi;

- OBLIGOHET – AK që Ri-vlerësimi të bëhet duke marrë masa korrigjuese për eliminimin e lëshimit të përsëritjeve ligjore dhe vendimi të mirret duke respektuar në plotni dispozitat dhe rregullat e prokurimit duke u bazuar edhe ne Vendimin PSH.nr.466/16 ngase gjasat potenciale për tu shpërblyer me kontratë në këtë aktivitet është OE "EL BAU sh.p.k."si ofertuesi i vetëm i pergjegjshem me çmimin më të ulët që ploteson te gjitha kriteret e kerkuara ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, dhe fituesi të shpërblehet në respektim të Ligjit – LPP.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

OE "EL-BAU" Sh.p.k. në cilësi të "palës së interesuar" siç parashikohet me këtë ligj pretendon se është dëmtuar dhe i janë shkelur të drejtat nga vendimi i kundërligjshëm AK-së në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara pasi që me vendimin për eliminim të OE "EL-BAU" pa u bazuar në gjendjen faktike dhe juridike iu është cënuar e drejta të shpërblehet me kontrat si ofertuesi i pergjegjshem me çmimin më të ulët.
Do të ndiqen të gjithë hapat ligjorë të ankimimit në të gjitha shkallët për të realizuar të drejtën tonë ligjore për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nëse vendimi i njejtë mbetet në fuqi gjatë fazës së rishqyrtimit nga organi i shkallës së njejtë. Shpresojmë që organi që ka nxjerrur vendimet në fjalë gjatë rishyqrtimit të evitojë shkeljet e identifikuara nga ne të cilat janë të mbështetura në fakte dhe dëshmi materiale si dhe bazuar në to të nxjerr një vendim të saktë, të ligjshëm dhe meritor.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Ankesës i bashkangjiten ne kopje vetëm dokumentet që kanë rrjedhur pas Ri-vlerësimit ndërsa për dokumentet dhe provat tjera ju lutemi t"i referoheni lëndës PSH.NR.466/16 ngase të gjitha dëshmitë dhe provat janë bashkangjitur në Ankesën Nr.466/16

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*